



Përditësim

Mirë se vini në informimin javor të Dhomave të Specializuara të Kosovës, ku synojmë t'u ofrojmë gazetarëve informacion të përditësuar mbi zhvillimet më të fundit në Gjykatë dhe mundësinë për të bërë pyetje.

Gjykimi i Hashim Thaçit, Kadri Veselit, Jakup Krasniqit dhe Rexhep Selimit filloi këtë javë me deklaratat hyrëse të hënën, martën dhe të mërkurën.

Katër të akuzuarit ngarkohen me përgjegjësi penale individuale për gjashtë akuza për krime kundër njerëzimit: përndjekje, burgosje, akte të tjera çnjerëzore, torturë, vrasje të paligjshme dhe zhdukje me forcë të personave, si dhe për katër akuza për krime lufte: arrestim dhe ndalim i paligjshëm ose arbitrar, trajtim mizor, torturë dhe vrasje të paligjshme.

Që të katër të akuzuarit u vetëdeklaruan të pafajshëm në lidhje me të gjitha akuzat.

Më 3 prill, Zyra e Prokurorit të Specializuar dhe Mbrojtësi i Viktimave dhanë deklaratat hyrëse të tyre. Më 4 prill, ekipet e Mbrojtjes së z. Thaçi, z. Veseli, dhe z. Selimi dhanë deklaratat hyrëse. Z. Thaçi dhe z. Selimi, që të dy, dhanë deklarata pa betim, në përputhje me rregullën 142(1) të Rregullores.

Më 5 prill, ekipi i Mbrojtjes së Jakup Krasniqit dha deklaratën hyrëse. Z. Krasniqi dha deklaratë pa betim.

Paraqitja e provave nga Prokuroria dhe thirrja e dëshmitarit të parë u planifikua të fillojë më 11 prill 2023.

Seancat e gjykimit janë planifikuar për pjesën tjetër të këtij viti dhe mund të ndiqen nëpërmjet faqes së internetit në shqipe, serbishte dhe anglishte, dhe nga galeria publike në gjykatë. Për më shumë informacion lidhur me orarin e seancave, shihni kalendarin e gjykatës në faqen e internetit të DHSK-së.

Në të njëjtën çështje, në bazë të urdhrin të Trupit Gjyqësor, ZPS-ja dorëzoi, më 3 prill, versionin e redaktuar publik të dosjes paraprake të korrigjuar.

Në çështjen e Salih Mustafës, Trupi Gjyqësor sot shqiptoi urdhrin për zhdëmtim. Më 16 dhjetor 2022, Trupi Gjyqësor e shpalli z. Mustafa fajtor për krime lufte të ndalimit arbitrar, torturës dhe vrasjes së paligjshme dhe e dënoi me 26 vjet burgim. Mbrojtja është duke e apeluar aktgjykimin dhe së fundi iu miratua pjesërisht kërkesa për shtyrje të afatit për dorëzim të dosjes së apelit deri më 23 prill 2023.

Në bazë të urdhrin për zhdëmtim, të lëshuar sot në këtë çështje, Trupi Gjyqësor urdhëroi z. Mustafa të paguajë një shumë të gjithsejtë prej 207.000 euro si kompensim për dëmin e shkaktuar ndaj viktimave të krimeve për të cilat është shpallur fajtor.





Trupi Gjykses vendosi se kompensimi i secilës prej viktimave mbi bazë individuale është lloji dhe modaliteti më i përshtatshëm për zhdëmtim dhe urdhëroi shuma të ndryshme për t'u paguar për secilën prej viktimave pjesëmarrëse, që nga 2000 euro deri në 80.000 euro. Këto shuma burojnë nga kërkesa e Mbrojtëses së Viktimave, që Trupi Gjykses i gjykoi të arsyeshme dhe që pasqyrojnë shkallën dhe përmasat e dëmit që pësuan viktimat.

Trupi Gjykses theksoi se juridiksioni i tij në këtë çështje gjyqësore do të përfundojë me nxjerrjen e këtij Urdhri për Zhdëmtim. Rrjedhimisht, Trupi Gjykses ftoi Kryetaren e DHSK-së të caktojë një autoritet gjyqësor përgjegjës për monitorimin dhe mbikëqyrjen e vënies në jetë dhe zbatimin të këtij Urdhri për Zhdëmtim.

Megjithëse Trupi Gjykses rikujtoi se përgjegjësinë për pagesën e kompensimit për viktimat e mban ekskluzivisht z. Mustafa, ai theksoi se në kohën e lëshimit të Urdhrit për Zhdëmtim, z. Mustafa nuk zotëron mjete financiare për zbatimin e plotë të këtij urdhri. Rrjedhimisht, Trupi Gjykses theksoi nevojën për përfshirjen e aktorëve të tjerë për zbatimin e Urdhrit për Zhdëmtim, sidomos Kosovën. Në këtë aspekt, Trupi Gjykses tha se programi i Kosovës për kompensimin e viktimave të krimit mund të jetë një alternativë për zbatimin e Urdhrit për Zhdëmtim, edhe pse shumat maksimale që mund të akordohen nga ky program janë më të ulëta se ato të përcaktuara në Urdhrin për Zhdëmtim.

Rrjedhimisht, Trupi Gjykses ftoi Kosovën që të krijojë një mekanizëm të ri për viktimat e krimeve të përfshira në juridiksionin e DHSK-së për të garantuar trajtimin e barabartë midis viktimave dhe të dyshuarve ose të akuzuarve në proceset e DHSK-së, të cilët mbështeten financiarisht për mbrojtjen e tyre nëpërmjet buxhetit të Kosovës, ndërsa asgjë nuk parashihet për viktimat e krimeve të përfshira në juridiksionin e DHSK-së. Gjithashtu, Trupi Gjykses vëren se legjislacioni i Kosovës që trajton dëmin dhe lëndimet e pësuar në kontekstin e luftës në Kosovë gjatë viteve 1998-1999, u referohet ekskluzivisht viktimave prej forcave të armikut, që sipas mendimit të Trupit Gjykses, krijon diskriminim midis viktimave të luftës.

Krahas kësaj, Trupi Gjykses rekomandoi krijimin e një fondi për viktimat e krimeve të përfshira në juridiksionin e DHSK-së, me nismën e DHSK-së, në rast se Kosova nuk i përmbush detyrimet që ka ndaj viktimave brenda një kohe të arsyeshme përmes krijimit të një mekanizmi për zhdëmtim. Fondi duhet të mbështetet financiarisht para së gjithash nga Kosova, si dhe nga shtete dhe donatorë të tjerë që dëshirojnë t'u ofrojnë mbështetje viktimave

Pyetje nga gazetarët

